



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

**Zyra e Kryetarit të Komunës  
Kancelarija Predsednika Opstine/Mayor's Office**

02 Nr. 129  
Datë: 22.04.2022

Komuna e Shtimes duke u bazuar në nenin 34 pika 12 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114 dhe te neni 18 pika 1 dhe 2 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Kryetari i Komunës bënë:

**SH P A L L J E P U B L I K E**

**I. Për angazhimin e një (1) eksperti të jashtëm, për të qenë pjesë e Komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të kandidatëve për konkurset në pranim, ekspert të burimeve njerzore nga organizata të specializuara apo Universitet të fushës**

**II. Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i komisionit për pranim në shërbimin civil dhe do të kryej detyrat e tij ashtu si janë përcaktuar në rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrieren në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e që janë:

1. Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimit dhe përvojës domethënëse në punë.

2. Vlerësimin e trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse.

3. Vlerësimin e njohurive, aftësive apo cilësitë e kandidatit nëpërmjet intervistës me gojë.

**II. Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kritere:**

1. Diplomë universitare në fushën: Burime Njerzore ose të Universitetit të fushës (Ekonomik, Juridik, Administratë Publike) me të paktën 240 kredi.

2. Kontratë ose vërtetim që dëshmon marrëdhënien e punës me Universitete të fushës.

3. Për personat që kanë diplomuar jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës nga MASHT-i.

4. Së paku 4 vite përvoje pune pas diplomimit, në fushën profesionale të nivelit drejtues

5. Të mos jenë të emëruar politik

6. Të mos jenë shërbyes civil

9. Të drejtë konkurimi kanë kandidatët nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës.

7. Të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
8. Të drejtë konkurimi kanë kandidatët nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës.  
**Angazhimi në cilësinë e ekspertit të jashtëm nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Komunën e Shtimes, mirëpo eksperti do të angazhohet për një periudhë të caktuar kohore.**

#### **IV. Kandidatet duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

1. Biografi (CV)
2. Kopjen e letërnjoftimit
3. Dëshminë për studimet universitare fotokopje e diplomës e vërtetuar nga noteri
4. Dëshmi mbi përvojën e punës
5. Dëshmi që nuk është nën hetime
6. Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatët që aplikojnë.

**Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Shtimes.**

**Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Shtimes.**

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk hyjnë në përzgjedhje nuk do të kontaktohen.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.

Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.



OEMAJI ALIU  
Kryetar i Komunës